**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**
*Qeveria - Vlada - Government*

---

**Nr. 01/88**
**Datë: 05.02.2019**

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 15/2017, me Rregulloren Nr. 16/2017, me Rregulloren Nr. 07/2018, me Rregulloren Nr. 26/2018 dhe me Rregulloren Nr. 30/2018, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 5 shkurt 2019, nxjerr këtë:

# V E N D I M

1. Aprovohet Rregullorja për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores Nr. 16/2013 për Strukturën Organizative të Zyrës së Kryeministrit, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 02/2017 dhe Rregulloren Nr. 08/2018.

2. Obligohet Zyra e Kryeministrit dhe institucionet tjera kompetente për zbatimin e Rregullores nga pika 1. e këtij vendimi.

3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

**Ramush HARADINAJ**

Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë

**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**
*Qeveria - Vlada - Government*

**Nr. 02/88**
**Datë: 05.02.2019**

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 15/2017, me Rregulloren Nr. 16/2017, me Rregulloren Nr. 07/2018, me Rregulloren Nr. 26/2018 dhe me Rregulloren Nr. 30/2018, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 5 shkurt 2019, nxjerr këtë:

**V E N D I M**

1. Ndahen mjete financiare në vlerë 50.000,00 (pesëdhjetëmijë) euro për mbulimin e shpenzimeve për shërim jashtë vendit të znj. Arite Sylejmani.

2. Mjetet nga pika 1. e këtij vendimi ndahen nga Shpenzimet e Paparashikuara me kod 232 nën programi Shpenzimet e Paparashikuara me kod 13100, kategoria e shpenzimeve e rezervës dhe transferohen në Ministrinë e Financave në nën programin Thesari me kod 201-11200 në kategorinë e shpenzimeve subvencione dhe transfere.

3. Obligohet Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

**Ramush HARADINAJ**

Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë

**Republika e Kosovës**

**Republika Kosova - Republic of Kosovo**

***Qeveria - Vlada - Government***


**Nr. 03/88**

**Datë: 05.02.2019**

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 15/2017, me Rregulloren Nr. 16/2017, me Rregulloren Nr. 07/2018, me Rregulloren Nr. 26/2018 dhe me Rregulloren Nr. 30/2018, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, duke shqyrtuar kërkesën e Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë, me nr. prot. 261, datë 04.02.2019, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 5 shkurt 2019, nxjerr këtë:

## V E N D I M

1. Aprovohet rekomandimi i Komisionit Ndërministror për Investime Strategjike për dhënien e statusit investitor strategjik për subjektin investues "SOWI KOSOVO L.L.C".
2. Emri i projektit investues është Kosovo Windpower: Selac 1, Selac 2, Selac 3.
3. Vlera e kapitalit të investimit strategjik është 169,093,575.00 euro brenda periudhës pesë (5) vjeçare.
4. Emri i investitorit është "SOWI KOSOVO L.L.C".
5. Projekti investues është projekti privat.
6. Investimi strategjik do të realizohet në Selac, Bajgore, Komuna e Mitrovicës.
7. Prona në të cilën do të behet investimi strategjik është pronë private.
8. Autorizohet Komisioni Ndërministror për Investime Strategjike që të negocioj marrëveshjen me subjektin investues "SOWI KOSOVO LUC".

## A r s y e t i m

Duke u bazuar në rekomandimin e Grupit Operacional për shqyrtimin dhe vlerësimin e dokumentacionit të aplikuesit-subjektit investues "SOWI KOSOVO L.L.C. me nr. ref. 930, i datës 31.01.2019 dhe rekomandimin e Komisionit Ndërministror për Investime Strategjike, me të cilët konstatohet se subjekti investues "SOWI KOSOVO L,L,C", i ka plotësuar të gjitha kushtet dhe kriteret e përcaktuara me Ligjin Nr. 05/L-079 për Investime Strategjike dhe Udhëzimin Administrativ Nr. 15/2018 për Mënyrën dhe Metodat e Verifikimit të Përmbushjes së Kritereve për Përcaktimin e Statusit të Investitorit Strategjik, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

9. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

**Ramush HARADINAJ**

Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë

**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**
*Qeveria - Vlada - Government*

---

**Nr. 04/88**
**Datë: 05.02.2019**

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 7 paragrafi 5. të Ligjit Nr. 04/L-052 për Marrëveshjet Ndërkombëtare, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr.15/2017, me Rregulloren Nr.16/2017, me Rregulloren Nr. 07/2018, me Rregulloren Nr. 26/2018 dhe me Rregulloren Nr. 30/2018, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 5 shkurt 2019, nxjerr këtë:

## V E N D I M

1. Aprovohet propozimi i Ministrisë së Punëve të Brendshme për të kërkuar nga Presidenti i Republikës së Kosovës dhënien e autorizimit Ministrit të Punëve të Brendshme për nënshkrimin e Marrëveshjes ndërkombëtare ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë për Heqjen Graduale të Kontrolleve në Kufirin e Përbashkët.

2. Qeveria e Republikës së Kosovës i rekomandon Presidentit të Republikës së Kosovës dhënien e autorizimit për nënshkrimin e Marrëveshjes nga pika 1. e këtij vendimi, në përputhje me Ligjin për Marrëveshjet Ndërkombëtare.

3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

**Ramush HARADINAJ**

Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë

**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**
*Qeveria - Vlada - Government*

---

**Nr. 05/88**
**Datë: 05.02.2019**

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 15/2017, me Rregulloren Nr. 16/2017, me Rregulloren Nr. 07/2018, me Rregulloren Nr. 26/2018 dhe me Rregulloren Nr. 30/2018, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 5 shkurt 2019, nxjerr këtë:

## V E N D I M

1. Aprovohet në parim Nisma e Ministrisë së Punëve të Jashtme për aderim në ICMP, Komisioni Ndërkombëtar për Persona të Zhdukur.

2. Obligohet Ministria e Punëve të Jashtme dhe Zyra e Kryeministrit që në pajtim me procedurat ligjore të finalizoj këtë proces, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

3. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

**Ramush HARADINAJ**

Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë

**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**
*Qeveria - Vlada - Government*

---

**Nr. 06/88**
**Datë: 05.02.2019**

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 4 paragrafi 2. të Ligjit Nr. 04/L-052 për Marrëveshjet Ndërkombëtare, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 15/2017, me Rregulloren Nr. 16/2017, me Rregulloren Nr. 07/2018, me Rregulloren Nr. 26/2018 dhe me Rregulloren Nr. 30/2018, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 5 shkurt 2019, nxjerr këtë:

**V E N D I M**

1. Aprovohet në parim Nisma e Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale për lidhjen e Marrëveshjes për Sigurime Sociale ndërmjet Qeverisë së Republikës së Maqedonisë dhe Qeverisë së Republikës së Kosovës.

2. Përgjatë negocimit të kësaj marrëveshjeje, Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale obligohet të procedojë konform dispozitave të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të Ligjit për Marrëveshjet Ndërkombëtare dhe dispozitave tjera ligjore në fuqi.

3. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

**Ramush HARADINAJ**

Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë

**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**
*Qeveria - Vlada - Government*

**Nr. 07/88**
**Datë: 05.02.2019**

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 4 paragrafi 2. të Ligjit Nr. 04/L-052 për Marrëveshjet Ndërkombëtare, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 15/2017, me Rregulloren Nr. 16/2017, me Rregulloren Nr. 07/2018, me Rregulloren Nr. 26/2018 dhe me Rregulloren Nr. 30/2018, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 5 shkurt 2019, nxjerr këtë:

## V E N D I M

1. Aprovohet në parim Nisma e Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale për lidhjen e Marrëveshjes për Sigurime Sociale ndërmjet Qeverisë së Republikës së Malit të Zi dhe Qeverisë së Republikës së Kosovës.

2. Përgjatë negocimit të kësaj marrëveshjeje, Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale obligohet të procedojë konform dispozitave të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të Ligjit për Marrëveshjet Ndërkombëtare dhe dispozitave tjera ligjore në fuqi.

3. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

**Ramush HARADINAJ**

Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë

**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**
***Qeveria - Vlada - Government***

**Nr. 08/88**
**Datë: 05.02.2019**

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 4 paragrafi 2. të Ligjit Nr. 04/L-052 për Marrëveshjet Ndërkombëtare, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 15/2017, me Rregulloren Nr. 16/2017, me Rregulloren Nr. 07/2018, me Rregulloren Nr. 26/2018 dhe me Rregulloren Nr. 30/2018, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 5 shkurt 2019, nxjerr këtë:

**V E N D I M**

1. Aprovohet kërkesa e Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor për miratimin e Nismës për negocimin e marrëveshjes për anëtarësimin e Republikës së Kosovës në Unionin Ndërkombëtar për Ruajtjen e Natyrës.

2. Përgjatë negocimit të kësaj marrëveshjeje, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor obligohet të procedojë konform dispozitave të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të Ligjit për Marrëveshjet Ndërkombëtare dhe dispozitave tjera ligjore në fuqi.

3. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

**Ramush HARADINAJ**

Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë

**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**
***Qeveria - Vlada - Government***

---

**Nr. 09/88**
**Datë: 05.02.2019**

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 15/2017, me Rregulloren Nr. 16/2017, me Rregulloren Nr. 07/2018, me Rregulloren Nr. 26/2018 dhe me Rregulloren Nr. 30/2018, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 5 shkurt 2019, nxjerr këtë:

**V E N D I M**

1. Aprovohet Koncept Dokumenti për Administrimin e Ndërtesave të Banimit në Bashkëpronësi.

2. Obligohet Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe institucionet tjera kompetente për zbatimin e këtij vendimi, në pajtim me Rregulloren e Punës së Qeverisë.

3. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

**Ramush HARADINAJ**

Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë

**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**
*Qeveria - Vlada - Government*

**Nr. 10/88**
**Datë: 05.02.2019**

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 15/2017, me Rregulloren Nr. 16/2017, me Rregulloren Nr. 07/2018, me Rregulloren Nr. 26/2018 dhe me Rregulloren Nr. 30/2018, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, si dhe në pajtim me nenin 7 të Ligjit Nr. 05/L-054 për Mbrojtjen Juridike dhe Mbështetjen Financiare të Personave të Akuzuar Potencial në Proceset Gjyqësore Pranë Dhomave të Specializuara, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 5 shkurt 2019, nxjerr këtë:

**V E N D I M**

1. Aprovohen kërkesat për ndarjen e mjeteve financiare në vlerë 30,000 (tridhjetëmijë) euro për përkrahje financiare për personat e akuzuarve potencial në proceset Gjyqësore pranë Dhomave të Specializuara.

2. Mjetet nga pika 1. e këtij vendimi ndahen nga rezerva Shpenzimet e Paparashikueshme, nën programi Shpenzimet e Paparashikueshme me kod 232-13100 nga kategoria e shpenzimeve të rezervës.

3. Kërkesat nga pika 1. e këtij vendimi aprovohen si në vijim:

   3.1. Kërkesa me nr. 01.4-117, parashtruar nga z. Sami Lushtaku, në vlerë 9,187 (nëntëmijenjëqindetetëdhjeteshtatë) euro, aprovohet në tërësi;
   3.2. Kërkesa me nr. 01.1-154/2, parashtruar nga z. Mahir Hasani në vlerë 6,991 (gjashtëmijenëntëqindenëntëdhjetenjë) euro, aprovohet në tërësi;
   3.3. Kërkesa me nr. 01.1-176, parashtruar nga z. Sylejman Selimi, për ndarjen e 20,000 (njëzetmijë) euro, aprovohet pjesërisht, dhe të njëjtit i ndahet shuma në vlerë prej 13,822 (trembëdhjetëmijetetëqindenjëzetedy) euro.

4. Mjetet nga pika 1 e këtij vendimi transferohen në Ministrinë e Drejtësisë me kod 215, nën programi Mbrojtja Juridike dhe Mbështetja Financiare të Personave të Akuzuar Potencial në Proceset Gjyqësore Pranë Dhomave të Specializuara me kod 37900, kategoria e shpenzimeve subvencione dhe transfere.

5. Obligohet Ministria e Financave dhe Ministria e Drejtësisë për zbatimin e këtij vendimi.

6. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

**Ramush HARADINAJ**

Per ___________________

Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë